



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr: 164

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KORÇË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË DEMOKRACIA SOCIALE  
E SHQIPËRISË, Z. KRISTAQ JANI VASILI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1606 prot., datë 03.03.2022, këshilli i bashkisë Korçë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Petraq Vangjel Premti, propozuar nga Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale e Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Korçë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 03, z. Kristaq Jani Vasili.

Me shkresën nr.1857, prot., datë 23.03.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Korçë, z. Kristaq Jani Vasili, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 164

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale e Shqipërisë z. Kristaq Jani Vasili

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 26/1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Kristaq Jani Vasili, në këshillin e bashkisë Korçë, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 2036 prot., datë 05.04.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2035 prot., datë 05.04.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Kristaq Jani Vasili, në këshillin e bashkisë Korçë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 3427/1 prot., datë 19.04.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Kristaq Jani Vasili, në këshillin e bashkisë Korçë, i cili rezulton se ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, në rubrikën e mbiemrit nga “Vasil” në “Vasili”.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4054/1 prot., datë 08.04.2022 dhe shkresën nr. 4974/1 prot., datë 29.04.2022 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Kristaq Jani Vasili, në këshillin e bashkisë Korçë, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është i padënuar.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar z. Kristaq Jani Vasili në këshillin e bashkisë Korçë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave



të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

### **V E N D O S:**

1. Z. Kristaq Jani Vasili, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Korçë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratice Sociale e Shqipërisë, z. Kristaq Jani Vasili.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**

